



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 04/L –144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (”Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 20, paragrafi 3.2 të Rregullores QRK nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe të nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
AMBASADËS SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

- I.** Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pa procedurë të rregullt konkurrimi.
- II.** Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: parcelat kadastrale nr. 6160-0, 6161-0, 6145-0 dhe pjesët e parcelave kadastrale 6162-0, 6163-0, 6164-0, Zona kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme 8340 m², pronë shoqërore, Kuvendi komunal Prishtinë.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është për nevoja të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- IV.** Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë, për 99 vjet.
- V.** Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX.** Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë :
 - skica grafike,
 - kopja e planit dhe certifikata e pronës.



- X. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-464/01-263767/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

